

SHPALLJE E VENDI TË LIRË TË PUNËS**Forca Ajrore****Tabela .1**

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Inter vista	Fillimi	Mbarimi
1	Vrojtues meteorolog	Reparti Ushtarak nr. 3008, Laprakë, në Stacionin Meteorologjik, Gjirokaster, në Forcën Ajrore	Stacionin Meteorologjik, Bajram Curri	E pacaktuar	Me dosje	-	23.07.2025	06.08.2025

Formulari nr. 1

1. Pozicioni i punës:	“Vrojtues meteorolog”
2. Kodi i pozicionit:	3008B10006
3. Reparti/Institucioni:	Reparti Ushtarak nr. 3008, Forca Ajrore
4. Vendi:	Stacionin Meteorologjik, Gjirokaster
5. Paga:	Trajtohet me pagë sipas VKM nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punjonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike”, i ndryshuar, Lidhja nr. II, kreu II/I me Klasën VIII (44.100) dhe shtesë mbi pagë për punë të vështirë e të dëmshme për shëndetin”, me shkallën e II/dh, me vlerë leku 4000 (katër mijë) dhe shtesë për natyrë të veçantë pune me vlerë leku 4000 (katër mijë).
6. Lloji i kontratës së punës:	E pacaktuar
7. Data e fillimit të aplikimit:	23.07.2025
8. Data e mbylljes së aplikimit:	06.08.2025
9. Mënyra e aplikimit:	Me dosje
10. Dokumentat e aplikimit:	Aplikantët duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtëm; • Kërkesën personale; • Formularin e aplikimit; • Fotokopje të kartës së identitetit; • Dëftesën e shkollës së mesme të noterizuar me origjinalin; • Diplomë e arsimit të lartë/listë notash të noterizuar me origjinalin; • Fotokopje e patentës nëse ka; • Çertifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja; • Raport mjekësor; • Fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12, 2 copë; • Dëshmi penaliteti; • Vërtetim gjykata;

- Vërtetim prokurorie;
- Librezë pune;
- Jetëshkrim (CV);
- Formulari i vetëdeklarimit;

11. Kërkesa të përgjithshme të vendit të punës:

- Të ketë shtetësi shqiptare;
- Të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të plotësojë kriteret për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin e përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- Të mos jetë i denuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- Të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

10. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- Grada/Titulli: Civil (CII);
- Arsimi : I mesëm i përgjithshëm ose i lartë;
- Kualifikimi: Të ketë experience pune dhe aftësi të mira organizative, komunikuese dhe prezantuese;
- Trajnimi: Kurse dhe kualifikime të ndryshme në fushën e meteorologjisë;
- Eksperienca në Punë: 3 vjet;
- Gjuha e huaj: Të ketë njohuri të bazë;
- Kërkesa të tjera specifike: Të ketë njohuri të mira për përdorimin e programeve kompjuterik si dhe eksperience në fushën e meteorologjisë;
- Niveli i certifikatës së sigurisë; E paaplikueshme

11. Përshkrimi i punës:

Detyrat kryesore:

- Organizimi dhe koordinimi i punës për kryerjen e matjes së elementëve meteorologjik me anë të instrumentave të certifikuar sipas orareve të përcaktuara nga rregulloret e OBM dhe ICAO për vërtetimet SYNOP, METAR.
- Përpilon telegramet SYNOP, METAR duke përdorur kodet meteorologjike, tabelat psikometrike si dhe me anë të programit COMPILA bën transmetimin në kohë sipas orareve në Sektorin e Operacioneve .
- Furnizon dhe mbështet me informacion shtesë në çdo kohë aktivitetet e FA.
- Ndjek në vazhdimësi evoluimin e elementëve meteorologjik si vranësirë, shikimin, erën dhe fenomenet e ndryshme meteorologjike në vecanti ato që kanë impakt në fluturim dhe njofton në çdo kohë Sektorin e Operacioneve, për çdo ndryshim në shtimin apo pakësimin e tyre.
- Regjistron në ditaret SYNOP, METAR të dhënat meteorologjike dhe telegramet.
- Çdo ditë të hënë bën ndërrimin e diagramave të instrumentave regjistruar, plotësimin e tyre dhe i bën gati për arkivim në arkivin e SHMU.

g) Harton dhe plotëson të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të zyrës sipas legjislacionit në fuqi.

h) Kryen detyra sigurie për kohën e punës, sipas turnit dhe orarit.

Përgjegjësitë: Përgjigjet për zbatimin e të gjitha kërkesave rregulloreve dhe manualeve që përdoren për mbajtjen në gadishmëri të mjeteve dhe pajisjeve të kopshtit meteorologjik.

12. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Ajrore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët.

Komisioni verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit.

Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse);

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.